

VENDIM
Nr. 314, datë 4.6.2025

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR QASJEN NË ARSIMIN E LARTË DHE PRANIMIN PËR TË STUDIUAR NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes për qasjen në arsimin e lartë dhe pranimin për të studiuar në Ballkanin Perëndimor, të nënshkruar në Berlin, më 14.10.2024, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

MARRËVESHJE
PËR QASJEN NË ARSIMIN E LARTË DHE PRANIMIN PËR TË STUDIUAR NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Përfaqësuesit e Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Kosovës^ÿ, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë (në vijim të referuara si “Palët”),

duke marrë parasysh “Deklaratën e Udhëheqësve të Ballkanit Perëndimor për Tregun e Përbashkët Rajonal – Një katalizator për integrim më të thellë ekonomik rajonal dhe një hap drejt Tregut të Vetëm të BE-së, të miratuar në Samitin e Udhëheqësve të Ballkanit Perëndimor, në kuadër të Procesit të Berlinit;

duke njohur rëndësinë e lëvizjes së lirë të njerëzve, me qëllim lehtësimin e qasjes dhe pranimin të të diplomuarve nga arsimi i mesëm dhe të studentëve të Palëve, të cilët dëshirojnë të fillojnë studimet e tyre në institucionet publike të arsimit të lartë në secilën prej Palëve në fjalë;

duke marrë parasysh se lista e institucioneve publike të arsimit të lartë do të specifikohet nga Komisioni i Përbashkët për Njohjen e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë në Ballkanin Perëndimor;

me dëshirën për të nxitur dhe forcuar lidhjet e ngushta dhe zgjeruar themelet e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit në Ballkanin Perëndimor;

të bindur se kjo Marrëveshje do të rrisë cilësinë e arsimit të lartë, do të nxisë ngritjen e programeve të përbashkëta të studimit dhe do të promovojë mobilitetin akademik dhe atë studentor, si dhe zhvillimin e programeve të shkëmbimit brenda Palëve;

të angazhuar për të zbatuar dispozitat e kësaj Marrëveshjeje në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese, pa paragjykim bazuar në racë, etni, kombësi, gjini, moshë, besim fetar, orientim seksual, pakicë kombëtare, paaftësi apo ndonjë bazë tjetër,

kanë rënë dakord si më poshtë:

^ÿKy përcaktim nuk cenon qëndrimet ndaj statusit dhe është në përputhje me rezolutën 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së për Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës.

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Kjo Marrëveshje rregullon qasjen në arsimin e lartë dhe pranimin për të studiuar në institucionet publike të akredituara të arsimit të lartë të Palëve, me qëllim fitimin e së drejtës për të studiuar në secilën prej Palëve. Të drejtat për arsimim falas, për strehim dhe bursë rregullohen në përputhje me kuadrin ligjor të secilës Palë.

2. Palët bien dakord t'u japin aplikantëve nga Palët e tjera qasje dhe pranim në institucionet publike përkatëse të Arsimit të Lartë me kritere të njëjta apo të barasvlershme qasjeje dhe pranimi si për aplikantët nga Pala pritëse.

Neni 2

1. Kjo Marrëveshje zbatohet në të gjitha nivelet e arsimit të lartë.

2. Kjo Marrëveshje nuk cenon, as derogon ndonjë masë, praktikë apo marrëveshje të mëparshme ndërmjet dy a më shumë Palëve që është më përfituese për personat të cilët kanë një diplomë të arsimit të mesëm apo që kanë kualifikime të arsimit të lartë, si dhe nuk paraqet pengesë për krijimin e ndonjë mase, praktike apo marrëveshjeje të tillë të mëtejshme.

Neni 3

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termat e poshtëshënuar përkufizohen si vijon:

a) “Qasja në arsimin e lartë” i referohet së drejtës së kandidatëve të kualifikuar për të aplikuar dhe për t'u konsideruar për pranim në arsimin e lartë;

b) “Pranimi për të studiuar” i referohet aktit apo sistemit që i mundëson aplikantëve të kualifikuar ndjekjen e studimeve në arsimin e lartë në një institucion publik të caktuar të arsimit të lartë dhe/apo në një program të caktuar;

c) “Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL-të)” u referohen institucioneve publike të akredituara të arsimit të lartë në Ballkanin Perëndimor, lista e të cilëve do të specifikohet nga Komisioni i Përbashkët për Njohjen e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë në BP6;

d) “Pala e origjinës” i referohet Palës nga ku studenti ka marrë kualifikimet e tij;

e) “Pala pritëse” i referohet Palës ku studenti dëshiron të regjistrohet pranë një IAL-je;

f) “Qasja e barasvlershme” në arsimin e lartë dhe kriteret për pranim për të studiuar, u referohet të gjitha kriterëve të përcaktuara në kuadrin ligjor të Palës pritëse.

Neni 4

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk nënkuptojnë asnjë përjashtim apo trajtim preferencial nga legjislacioni aktual në fuqi për lejen e qëndrimit në Palët përkatëse.

Neni 5

Nëse për pranimin për të një program studimi të caktuar të arsimit të lartë nevojiten kualifikime apo arritje specifike në një fushë apo fusha të veçanta, aplikantët nga Palët e tjera nënshkruese të kësaj

Marrëveshjeje i përmbushin të tilla kërkesa për kushte, të cilat korrespondojnë me ato që i kërkojnë aplikantët të përmbushë nga Pala pritëse.

Neni 6

1. Nëse numri i pranimeve në programet e studimit të arsimit të lartë është i kufizuar, përzgjedhja e aplikantëve nga Palët e tjera nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje kryhet në përputhje me rregullat e njëjta apo të barasvlershme me ato të aplikantëve nga Pala pritëse. Në këtë mënyrë, Palët do të zbatojnë ato rregulla pranimi që, në pjesën më të madhe të mundshme, u përshtaten aplikantëve nga Palët e tjera nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje, ashtu si veprohet edhe me aplikantët të cilët janë nga Pala pritëse.

2. Palët japin informacion mbi programet e studimit që ofrohen nga institucionet e ndryshme të arsimit të lartë në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor.

KAPITULLI II

NJOHJA E KUALIFIKIMEVE TË ARSIMIT TË MESËM PËR QASJE NË ARSIMIN E LARTË DHE PRANIMIN PËR TË STUDIUAR

Neni 7

1. Për qëllime qasjeje dhe pranimi në arsimin e lartë, Komisioni i Përbashkët për Qasjen në Arsimin e Lartë dhe Pranimin në Programet e Studimit në Ballkanin Perëndimor harton dhe dakordësohet për një listë të përbashkët institucionesh të arsimit të mesëm, siç përcaktohet në nenin 8 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Secila Palë njeh kualifikimet e lëshuara nga Palët e tjera që plotësojnë kriteret e përgjithshme për qasje në arsimin e lartë në ato Palë, për qëllim të qasjes në programet e studimit që i përkasin sistemit të arsimit të lartë, përveç nëse ka ndonjë ndryshim thelbësor në kërkesat e përgjithshme për qasje. Ky ndryshim thelbësor duhet të shpjegohet në mënyrë të hollësishme në vendim.

3. Në ato raste, kur kualifikimi mundëson qasjen vetëm të tipa specifikë institucionesh apo programesh të arsimit të lartë në Palën ku është marrë ky kualifikim, secila Palë tjetër u jep mbajtësve të këtij kualifikimi qasje në programe specifike të ngjashme në institucione të sistemit të arsimit të lartë, përveç nëse ka ndonjë ndryshim thelbësor në kërkesat për qasje. Ky ndryshim thelbësor duhet të shpjegohet në mënyrë të hollësishme në vendim.

4. Në rastet kur pranimi në programe të caktuara të arsimit të lartë varet nga përmbushja e kërkesave të veçanta përveç atyre të përgjithshme për qasje në Palën pritëse, institucionet publike të arsimit të lartë të Palës pritëse mund të vendosin të njëjtat kërkesa specifike për mbajtësit e kualifikimeve të Palëve të tjera ose mund të vlerësojnë nëse aplikantët me kualifikime të Palëve të tjera i përmbushin kërkesat specifike të barasvlershme.

5. Në rastet kur, në një Palë të caktuar, certifikata e përfundimit të arsimit të mesëm mundëson qasjen në arsimin e lartë, vetëm duke u shoqëruar me provime të tjera kualifikuese si parakusht për qasje, Palët e tjera mund ta japin qasjen, me kushtin e plotësimit të këtyre kërkesave ose mund të ofrojnë një alternativë për përmbushjen e këtyre kërkesave shtesë brenda sistemit të tyre arsimor.

6. Në rastet kur, në një Palë të caktuar, certifikata e përfundimit të arsimit të mesëm mundëson qasje në arsimin e lartë vetëm duke u shoqëruar me provime kualifikuese shtesë si parakusht për qasje, Palët e tjera mund ta kushtëzojnë qasjen me plotësimin e këtyre kërkesave, duke mundësuar ndjekjen e orëve mësimore, por jo dhënien e provimeve, ose të ofrojnë një alternativë për përmbushjen e këtyre kërkesave shtesë brenda sistemeve të tyre arsimore.

7. Pranimi në një institucion të caktuar të arsimit të lartë mundësohet me kusht që aplikanti të provojë kompetencë të mjaftueshme në gjuhën ose gjuhët e procesit mësimor në institucionin e arsimit të lartë në fjalë, ose në gjuhë të tjera të specifikuar.

8. Procedura e njohjes së kualifikimeve të arsimit të mesëm në të gjitha Palët, përfshirë rezultatet e provimit përfundimtar të arsimit të mesëm, dhe/ose rezultatet e provimit të maturës, kryhet brenda një periudhe maksimale prej 30 (tridhjetë) ditësh.

9. Në rastin kur procedura e njohjes nuk mbyllet brenda 30 ditëve, studenti mund të aplikojë për t'u regjistruar në IAL-në, me një konfirmim nga autoriteti kompetent se procesi i njohjes së kualifikimit të arsimit të mesëm vijon ende. Kjo dëshmi duhet të jetë e vlefshme për vetëm 30 ditë. Në ditën e pranimi, studenti duhet të depozitojë vendimin e lëshuar nga autoriteti kompetent për njohjen e kualifikimit të arsimit të mesëm.

Neni 8

1. Komisioni i Përbashkët për Qasjen në Arsimin e Lartë dhe Pranimin për të Studiuar në Ballkanin Perëndimor (Komisioni i Përbashkët) ngrihet bazuar në këtë Marrëveshje dhe ngarkohet me detyrën e organizimit, bashkërendimit dhe monitorimit të veprimtarive që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Komisioni i Përbashkët përbëhet nga deri në 3 përfaqësues nga secila Palë në këtë Marrëveshje.

3. Të gjitha vendimet e Komisionit të Përbashkët dakordësohen nga të gjitha Palët.

4. Komisioni i Përbashkët miraton rregullat e veta procedurale.

5. Komisioni i Përbashkët mbledhet të paktën dy herë në vit.

KAPITULLI III DISPOZITAT E PËRKOHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 9

1. Kjo Marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit, pranimi apo miratimit sipas kërkesave të parashikuara nga legjislacioni përkatës i Palëve. Njoftimi zyrtar i ratifikimit, pranimi, apo miratimit, depozitohet te Pala Depozitare.

2. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit të njoftimit të tretë zyrtar të ratifikimit, pranimi ose miratimit për ato Palë që kanë depozituar njoftimin e tyre zyrtar të ratifikimit, pranimi ose miratimit.

3. Për secilën Palë që depoziton njoftimin e vet zyrtar të ratifikimit, pranimi ose miratimit pas datës së depozitimit të njoftimit të tretë zyrtar të ratifikimit, pranimi ose miratimit, kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e tridhjetë pas datës kur kjo Palë depoziton njoftimin e vet zyrtar të ratifikimit, pranimi ose miratimit.

4. Maqedonia e Veriut vepron si Palë Depozitare dhe njofton të gjitha Palët për çdo njoftim të marrë, në përputhje me këtë nen dhe për çdo akt apo njoftim në lidhje me këtë Marrëveshje.

Neni 10

Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje që lind nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, të zgjidhet nga Komisioni i Përbashkët.

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me miratimin me shkrim të të gjitha Palëve, duke iu nënshtruar së njëjtës procedurë që nevojitet për lidhjen e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11

Nëse njëra Palë tërhiqet nga kjo Marrëveshje, marrëveshja pushon së qeni efektive për atë Palë brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të njoftimit për këtë qëllim të Pala Depozitare.

Marrëveshja hartohet në gjuhën angleze në versionin origjinal, i cili do të mbetet në zotërim të Palës Depozitare. Secila Palë do të marrë një kopje të certifikuar të Marrëveshjes.

Bërë në _____, më _____ 2024

[Nënshkrimet]